

Editorial

Mundësitë dhe Sfidat e Rregullimit të Internetit për Vetëlëndim dhe Parandalim të Vetëvrasjes

Jacqui Morrissey, Laura Kennedy dhe Lydia Grace

Samaritans, Ewell, MB

Përkthyer nga Diellëza Namani, Erlanda Gjeka, Viola Greiçevci

Të punuarit në ndikimin e politikës së qeverisë në parandalimin e vetëvrasjes në Mbretërinë e Bashkuar shpesh nënkupton punën me Departamentin e Shëndetit dhe Kujdesit Social të qeverisë rreth strategjive ndërqeveritare të parandalimit të vetëvrasjeve në Angli dhe po ashtu në Irlandën e Veriut, Skoci dhe Wales. Rrallë vjen një mundësi e cila përfshinë ndikimin në legjislacion, por kjo është çfarë është duke ndodhur tani. Në epokën e rritjes së risive digjitale dhe komunikimit, partia konservatore ka bërë një përkushtim në manifestin e saj për të bërë Mbretërinë e Bashkuar vendin më të sigurt në botë për të qenë online duke e mbrojtur lirinë e të shprehurit (Partia Konservatore dhe Unioniste, 2019). Qeveria është duke u konsultuar si ta bëjnë këtë që prilli i vitit 2019 (Qeveria HM, 2019), me përgjigje të konsultimit të publikuara në shkurt 2020, dhe dhjetor 2020 (Departamenti për Digjitalizim, Kulturë, Media & Sport, [DCMS], 2020). Rezultati është Projektligji i vitit 2021 (DCSM, 2021) i cili është publikuar në Maj 2021 dhe përshkruan një kuadro të re rregullatore për të trajtuar përmbajtjen e dëmshme në internet. Projektligji pritet të kalojë në parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2022, por edhe pasi që të miratohet në ligj, do të duhet të ketë një sërë kodesh të praktikës (udhëzime të ofruara nga rregullatori që zbaton dispozitat e projektligjit), të cilat japin më shumë detaje se çfarë përmbajtje mbulohet dhe cilat lloje të veprimit priten nga shërbimet online. Pyetja e madhe për vetëlëndim dhe parandalim të vetëvrasjes është nëse ky legjislacion i ri paraqet një sfidë apo një mundësi.

Natyra dhe Ndikimi i Përmbajtjes Online së Vetëlëndimit dhe Vetëvrasjes

Përmbajtja online për vetëlëndim dhe vetëvrasje mund të marrë shumë trajta, duke përfshirë postime vizuale dhe përshkruese të krijuar nga përdoruesit, artikuj të ri dhe media të tjera, dhe përmbajtje që prodhohen nga organizata politike, bamirëse, dhe të kujdesit shëndetësor. Kjo përmbajtje mund të përfshijë përkujtimore online, përshkrime të metodave të vetëlëndimit ose vetëvrasjes, llogari të përvojës së jetuar, sfida online, imazhe të shenjave ose plagëve dhe histori të shpresës dhe shërimit. Paraqitet në një gamë të gjerë të platformave të ndryshme online duke përfshirë edhe faqe të mediave sociale, forume online, dhe faqe të lojërave, për të përmendur disa nga to. Ndikimi i angazhimit me përmbajtje online që lidhet me vetëlëndim dhe vetëvrasje është kompleks dhe të dhënat rreth këtyre çështjeve, edhe pse po dalin, mbeten të limituara.

Shumë studime kanë raportuar që interneti mund të jetë një linjë e jetës për njerëz të cilët kanë përjetuar vetëlëndim dhe ndjenja për vetëvrasje për shkak se i lejon ata që të kenë qasje mbështetje emocionale (Davis & Lewis, 2019; Lavis & Winter, 2020; Mok et al., 2016) dhe këshilla dhe informim praktik (Lavis & Winter, 2020). Duke e parë që kërkimi i ndihmës në mes të individëve që përjetojnë ndjenja dhe sjellje të vetëvrasjes është shpesh i ulët (Biddle et al., 2004), interneti prezanton mundësi unike për parandalimin e vetëvrasjeve. Megjithatë, këto hapësira online mund të ekspozojnë përdoruesit e cenueshëm ndaj përmbajtjeve shqetësuese ose të dëmshme që rrezikojnë nxitjen ose përkeqësimin e ndjenjave të vetëlëndimit ose vetëvrasjes. Kjo mund të

rezultojë në efekte të ngjitjes (Arendt et al., 2019; Marchant et al., 2017), konkurrencë në mes të përdoruesve (Marchant et al., 2017), dhe rritje të njohurive për disponueshmërinë dhe vdekshmërinë e metodave të specifiketë vetëvrasjes (Biddle et al., 2012). Përmbajtja potencialisht e dëmshme përfshinë informacione të detajuara rreth metodave të vetëlëndimit ose vetëvrasjes si dhe diskutet “pro-vetëvrasje” që mund të inkurajojnë dhe normalizojnë këto sjellje. Megjithatë, të dhënat ekzistuese në atë që çfarë përmban një përmbajtje e dëmshme, kur dhe për kë, janë të përziera (Marchant et al., 2017) dhe hulumtime të mëtutjeshme janë të nevojshme.

Në mënyrë të rëndësishme, hulumtimet kanë treguar se ekspozimi ndaj përmbajtjeve të vetë-lëndimit dhe vetëvrasjes online është shpërndarë në mes të popullatës së përgjithshme. Në Angli, një studim i bazuar në një popullatë të njerëzve të ri të moshës 21 vjeçare ka raportuar që 22.5% janë përfshirë në përdorim të internetit lidhur me vetëlëndim dhe vetëvrasje (Mars et al., 2015). Gjithashtu, ky studim ka gjetur që 42.1% të të rinjve që kanë përjetuar vetëlëndim pa qëllim të vetëvrasjes dhe 70.2% të të rinjve që kanë bërë përpjekje për vetëvrasje, raportuan përdorim të internetit që lidhet me vetëlëndim apo vetëvrasje. Një kërkim nacional rreth vetëvrasjeve nga fëmijët dhe të rinjtë gjeti prova që përdorimi i internetit i lidhur me vetëvrasje ishte në më shumë se një të katërtën (26%) të vdekjeve nën moshat 20 vjeçare, dhe 13% në vdekjet e moshave 20-24 vjeçare (NCISH, 2017). Veç kësaj, Padmanathan et al. (2018) gjetën që prevalenca e përdorimit të internetit që lidhet me vetëlëndimin dhe vetëvrasjen ishte 8.4% tek të rriturit të cilët u shfaqën në departamentin e emergjencës në spital lidhur me vetëlëndimin dhe përpjekjen për vetëvrasje, dhe kjo u rrit deri në 26% në mes të të rinjve të moshës 18 vjeçare. Edhe pse është e vështirë të vijmë deri në konkluzione të zakonshme, këto gjetje tregojnë që përdorimi i internetit lidhur me vetëlëndim dhe vetëvrasje është në prevalencë të lartë në mes të njerëzve të cilët përjetojnë mendime për vetëvrasje dhe përfshihen në sjellje vetëvrasëse. Ndoshta kjo nuk është befusuese duke marrë parasysh që shumica prej nesh e përdorim internetin për të gërmuar rreth shumicës së gjërave në përditshmërinë tonë, por nëse ne nuk e kuptojmë plotësisht në çfarë përmbajtje jemi duke u përfshirë dhe ndikimin e kësaj përfshirje, atëherë ku mbetet legjislacioni i propozuar në këtë fushë?

Fushëveprimi i propozuar i Ligjit së Sigurisë Online

Projektligji (DCSM, 2021) përcakton se cilat shërbime online do të mbulohen dhe çfarë përmbajtje do të jetë në fushëveprim. Si përmbledhje, ai propozon:

- Të gjitha shërbimet nga përdoruesi në përdorues dhe shërbimet e kërkimit do të mbulohen nga legjislacioni: Kjo do të thotë çdo gjë ku përdoruesit mund të komunikojnë me njëri-tjetrin (përveç seksionet e komentimit në faqet e internetit të mediave të lajmeve), si dhe motorët e kërkimit.

Ky fushëveprim është i madh por bën përpjekje që të merr një qasje të balancuar ndaj dëmeve, e cila nënkupton që jo të gjitha shërbimet mbulohen në të njëjtën mënyrë. Ligji përdorë kategori të përmbajtjeve ilegale dhe përmbajtjeve legale por të dëmshme dhe vendosë një detyrë të kujdesit ndaj shërbimeve për t'i adresuar këto, duke u varur nga shtrirja e tyre (p.sh sa përdorues) dhe funksionaliteti.

- Për përmbajtjen që është ilegale: Çdo shërbim ose platformë do të nevojitet që të marrë masa për të pavarësisht madhësisë së tyre.
- Për përmbajtjen legale por të dëmshme: Të gjitha shërbimet do të kenë nevojë të tregojnë që janë duke mbrojtur fëmijët (të definuar si nën 18 vjeç), duke vendosur masa për tu siguruar që fëmijët të mos kenë qasje në përmbajtje të dëmshme në platformën e tyre. Platformat mund të vendosin se si ta bëjnë këtë. Për shembull, ato mund të vendosin masa që të heqin përmbajtjen e cila është legale por e dëmshme. Në mënyrë alternative, ata mund të heqin fëmijët nga qasja në shërbimet e tyre (psh., përmes teknologjive të verifikimit të moshës).
- Dhe një detyrë shtesë e kujdesit do të vendoset mbi shërbimet me arritjen dhe funksionalitetin më të lartë, të cilat njihen në ligj si “Shërbimet e kategorisë 1” (psh., gjigandët e mediave sociale si Facebook, Twitter dhe motorët e kërkimit si Google). Këto shërbime të kategorisë 1 do të kërkohet të mbrojnë të rriturit si dhe fëmijët nga përmbajtja legale por e dëmshme.

Ekziston një masë e madhe e përmbajtjes që mund të jetë legale por e dëmshme rreth një numri të madh të fushave të temave. Legjislacioni nuk do të përpjeket të mbulojë të gjithë përmbajtjen legale por të dëmshme, por do të vendosë disa zona të prioritetit që të mbulohen nga ligji. Irlanda është pak më përpara sesa Mbretëria e Bashkuar në sjelljen e legjislacionit në këtë çështje dhe tashmë ka propozuar që vetëvrasja është një fushë primare e përmbajtjes në legjislacionin e tyre. Në dhjetor 2021, një

komision parlamentar që u krijua për të ndërmarrë një kontroll para-legjislativ në Projektligj publikoi raportin e tij (Komiteti i Përbashkët për Pojektligjin e Sigurisë Online, 2021) me rekomandime për ndryshime në Projektligj. Kjo kërkonte rregullimin e kategorizimit të propozuar të shërbimeve në Projektligj, dhe sugjeroi një qasje më të nuancuar për njohjen e faktorëve të tillë si rreziku, arritja, baza e përdoruesit dhe performanca e sigurisë. Në kohën e shkrimit të këtij editoriali, qeveria ende nuk i ishte përgjigjur këtij raporti, por në shkurt 2022, ajo njoftoi se vetëvraska do të ishte një fushë prioritare e përmbytjes ilegale, që është një hap i parë i mirë. Megjithatë, vazhdon një debat i nivelit të lartë se si legjislacioni i propozuar të bëhet efektiv dhe praktik.

Sfida e përcaktimit të llojeve të përmbytjes

Për përmbytjen e cila lidhet me vetëvrasken dhe vetëlëndimin, një nga sfidat kryesore do të jetë përcaktimi i asaj që bie në kategoritë e ndryshme të paligjshme dhe të ligjshme, por edhe të dëmshme.

Projektligji mbulon të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, por përkufizimet mbi përmbytjen e paligjshme në lidhje me vetëvrasken, ndryshojnë në juridiksione të ndryshme. Në Angli, Uells dhe në Irlandën e Veriut, inkurajimi i vetëvraskës është i jashtëligjshëm (Akti mbi vetëvraskë 1961; Akti i Drejtësisë Penale [Irlanda e Veriut], 1966), dhe kështu çdo përmbytje në internet e cila inkurajon vetëvrasken do të ishte e paligjshme dhe për këtë arsye çdo shërbim online i mbuluar nga projektligji do të duhej ta trajtonte atë.

Në Angli dhe Uells, Komisioni i Ligjeve ka publikuar së fundmi rekomandime për reformimin e veprave penale të komunikimit për të trajtuar dëmet serioze që vijnë nga abuzimi në internet (Komisioni i Ligjit, 2021), duke përfshirë rekomandimin e një veprave penale të re të inkurajimit ose ndihmës serioze për vetëlëndim. Nëse kjo vepër e propozuar bëhet ligj, atëherë do të ofronte më shumë përmbytje që inkurajojnë këtë sjellje në kategorinë e paligjshme.

Projektligji i ri i sigurisë në internet do të jetë në mbarë Mbretërinë e Bashkuar, por pa shkelje paralele rreth inkurajimit të vetëvraskës ose vetëlëndimit në çdo juridiksion të Mbretërisë së Bashkuar, është e paqartë nëse kjo do të thotë se do të ketë dallime se cilat përmbytje do të konsiderohen të paligjshme varësisht prej juridiksionit në të cilin postohen online. Prandaj, një nga sfidat e para do të jetë të kuptuarit se si një ligj në mbarë Mbretërinë e Bashkuar do të zbatohet në

juridiksione të ndryshme matanë Mbretërisë së Bashkuar. Megjithatë, për platformat më të mëdha me shtrirje globale, është e drejtë të supozohet se ato gjithsesi do të kenë një qasje në mbarë Mbretërinë e Bashkuar ndaj çështjes, dhe ndoshta një qasje në mbarë Evropën.

Sfida tjetër e madhe për përmbytjen e lidhur me vetëlëndim dhe vetëvraskë, është përkufizimi i përmbytjes legale, por të dëmshme. Hulumtimi i ndërmarrë nga Samaritans dhe Universiteti i Bristolit u përpoq të kuptonte se si njerëzit përdorin internetin kur kanë mendime për vetëvraskë dhe treguan kompleksitetin e kësaj fushe të përmbytjes (Biddle et al., 2018). Ndikimi i ekspozimit ndaj llojeve të caktuara të përmbytjes së vetëlëndimit ose vetëvraskës në internet, mund të ndryshojë për njerëz të ndryshëm (Mok et al., 2016). Kjo do të thotë se përmbytja që mund të jetë e dëmshme për një person në një moment në kohë, mund të mos jetë e dëmshme për një person tjetër, ose mund të mos jetë e dëmshme për të njëjtin person në një moment të ndryshëm kohor.

Projektligji (DCMS, 2021) përfshin një përkufizim të gjerë të "përmbytjes që është e dëmshme për të rriturit". Seksioni 46(3) thotë se përmbytja konsiderohet të jetë e dëmshme për të rriturit nëse "ekziston një rrezik material që përmbytja të ketë, ose të ketë indirekt, një ndikim negativ fizik ose psikologjik të rëndësishëm tek një i rritur me ndjeshmëri të zakonshme". Projektligji (DCMS, 2021) përfshin një përkufizim të gjerë të "përmbytjes së dëmshme për të rriturit". Sipas seksionit 46(3), përmbytja konsiderohet e dëmshme për të rriturit nëse "ekziston një rrezik material që përmbytja të ketë ose tërthorazi të ketë një ndikim negativ fizik ose psikologjik të rëndësishëm te një i rritur me ndjeshmëri të zakonshme".

Megjithatë, kjo nuk na jep shumë për të vazhduar, dhe kështu korniza rregullatore, e cila do të përfshijë një sërë kodesh praktike, do të jetë kritike për përcaktimin e asaj që duhet të konsiderohet si e dëmshme për fushat prioritare të përmbytjes. Tashmë është njoftuar se Ofcom do të jetë rregullatori, dhe për deri sa Ofcom mund të fillojë disa punë paraprake në këto përkufizime, do të duhet pak kohë për të shkruar kodet. Duke qenë se projektligji me gjasë do të paraqitet në parlament në vitin 2022, potencialisht me një vit për t'u miratuar në ligj, është e vështirë të shihet se si do të jenë në fuqi kodet e praktikës para pranverës 2024. Koha e kësaj është një sfidë në vetvete dhe për ata që shqetësohen për dëmet që ndodhin tani, janë të frustruar se do të kalojnë ende disa vite përpara se shërbimet të kenë detyrën për të vepruar. Do të jetë thelbësore që Ofcom të punojë ngushtë me ekspertë të çështjes, duke përfshirë ata me përvojë të përjetuar të vetëlëndimit dhe vetëvraskës, për të plotësuar kodet praktike. Kodet do të duhet të rishikohen rregullisht, pasi që kuptimi ynë për ndikimin e përmbytjes

së vetëlëndimit dhe vetëvrasjes thellohet, teknologjia evoluon dhe shfaqen çështje të reja online. Nëse vetëlëndimi konsiderohet gjithashtu një prioritet në projektligj, siç është shpallur kohët e fundit për përmbajtje të paligjshme mbi vetëvrasjesjen, atëherë koha e hyrjes në kodet e reja të praktikës, na ofron të gjithëve një mundësi për të përmirësuar artikullimin tonë se çfarë është e dëmshme dhe e dobishme përpara se të zhvillohen këto kode.

Do të duhet gjithashtu të ndërmerren hapa nga qeveria, studiuesit dhe platformat për të monitoruar pasojat e paqëllimita dhe potencialisht të dëmshme të zbatimit të këtyre kodeve të praktikës. A do të rezultojë legjislati i ri që njerëzit të lëvizin në hapësira edhe më të errëta në internet për të gjetur dhe për të shpërndarë përmbajtje? A do të çojë heqja dhe ndalimi i shumë përmbajtjeve drejt stigmatizimit të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes dhe a do të zvogëlojë mundësitë e kërkimit të ndihmës për njerëzit që kanë nevojë për to? Me një bazë të kufizuar të provave ekzistuese në këtë fushë, ne pyetëm njerëzit me përvojë të jetuar për pikëpamjet e tyre dhe kemi paraqitur një përmbledhje të asaj që na thanë në seksionin vijues.

Pikëpamjet e personave me përvojë të jetuar të mendimeve, tentimeve dhe zisë

Kam pasur disa përvoja vërtet negative gjatë përdorimit të internetit, duke parë përmbajtje të vetëlëndimit kur isha më e re. Fatkeqësisht, nuk isha në dijeni se si kjo mund t'i përkeqësonte gjërat në të vërtetë dhe vazhdova të qasesha në këto faqe për një kohë të gjatë. Pavarësisht se përmbajtja ishte tepër e rrezikshme dhe nxitëse, unë vazhdova të kthehesha pas, pasi më jepte një ndjenjë përkatësie dhe një vend për të kërkuar këshilla. Kjo ishte diçka që më mungonte vërtet në jetën reale, dhe të qenit në gjendje të ndërveproja me njerëz të huaj me të njëjtat mendime, ishte shumë tërheqëse për mua në atë kohë.

Duke mësuar nga përvoja ime, tani jam jashtëzakonisht e kujdesshme me atë çfarë shikoj në internet – burimi im tani është një vend ku marr informacione të dobishme rreth shëndetit mendor, meme qesharake për të më gëzuar, frymëzim për receta dhe në fakt ndihet si një mjet pozitiv dhe i dobishëm, por më frikëson të mendoj se njerëzit e tjerë anëmbanë mund të jenë ende të ekspozuar ndaj anës së errët të internetit. Unë thjesht do të doja të kishte pasur më shumë masa mbrojtëse, kështu do të mund të kisha marrë lidhjen dhe mbështetjen që më duhej pa u ekspozuar ndaj përmbajtjes eksplicite dhe këshillave të pa kërkuara që çuan në më shumë dëm sesa dobi.

Ellie

Ky citim tregon qartë sfidën dhe mundësinë që mjedisi online i ofroi Ellie-t dhe i bën jehonë gjetjeve nga një studim i vogël njohurish, i ndërmarrë nga Samaritanët në vitin 2021 me 96 anëtarë të panelit tonë të përvojës së jetuar. Sondazhi eksploroj se çfarë mendonin njerëzit për propozimet e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar në projektligjin e sigurisë në internet 2021. Pjesëmarrësit e anketës ishin të moshës 18–65+ vjeç (7% nga moshë 18–24 vjeç, 42% nga moshë 25–44 vjeç, 45% nga moshë 45–64 vjeç, 6% e moshës 65+ vjeç), dhe shumica kishin përjetuar mendime për vetëvrasje (92%), vetëlëndim (66%), tentativa për vetëvrasje (63%) dhe zi nga vetëvrasja (27%). Nga këta të anketuar, 73% ishin femra, 22% ishin meshkuj dhe 5% të identifikuar si jobinarë. Ata na thanë si vijon:

Nevojiten ligje të reja për të trajtuar dëmet në internet

"Është shumë e parregulluar dhe si Perëndimi i Egër atje".

Shumica e të anketuarve (78%) ranë dakord se nevojiten ligje të reja për t'i bërë hapësirat në internet (të tilla si faqet e rrjeteve sociale dhe forumet) më të sigurta për përdoruesit. Të anketuarit shpjeguan se sistemi aktual "nuk është i përshtatshëm për qëllimin" dhe nevojiten ligje të reja për të rregulluar përmbajtjen e dëmshme, siç janë shpërndarja e metodave të vetëvrasjes, dhe imazhet grafike ose videot e vetëlëndimit ose vetëvrasjes. Të anketuarit gjithashtu donin që kompanitë e rrjeteve sociale të ishin përgjegjëse për përmbajtjen e dëmshme që ato prezantojnë në platformat e tyre.

Ligjet duhet të përfshijnë faqe interneti dhe forume më të vogla

"Nëse i largoni njerëzit nga faqet e njohura dhe të rregulluara të rrjeteve sociale, mund t'i shtyni ata "nëntokë" ku përmbajtja "pro" mund të bëhet më e përhapur dhe ekstreme."

Më shumë se tre të katërtat e të anketuarve (77%) ranë dakord se propozimet në Projektligj – të cilat mbulojnë vetëm platformat më të mëdha dhe më të njohura kur bëhet fjalë për përmbajtjet ligjore, por të dëmshme dhe mbi 18 vjeç – duhet të përfshijnë hapësira më të vogla online. Të anketuarit paralajmëruan se këto plane rrezikojnë të shtyjnë përmbajtjen e dëmshme dhe përdoruesit e cenueshëm në faqe më të vogla që kanë më pak gjasa të ofrojnë moderim dhe mbështetje. Shumë prej tyre mendonin gjithashtu se përmbajtja e vendosur në faqe më të vogla është shpesh më e rrezikshme për shkak të rritjes së anonimitetit dhe pranisë së përmbajtjes veçanërisht grafike.

Lloje të caktuara të përmbajtjes së dëmshme duhet të hiqen

Një total prej 77% e të anketuarve mendojnë se platformat në internet duhet të heqin disa lloje të përmbajtjeve të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes. Të anketuarit cituan tre kategori të përmbajtjes që ata mendonin se platformat duhet të ndërmarrin hapa për t'i hequr. Kategoria e parë ishte përmbajtje grafike e bazuar në imazhe, të tilla si përshkrime të qarta të vetëlëndimit dhe transmetimeve të drejtpërdrejta të vetëvrasjeve ose tentativave për vetëvrasje. Kategoria e dytë i referohej këshillave dhe informacioneve të hollësishme rreth metodave të vetëlëndimit ose vetëvrasjes. Kategoria e fundit ishte më e gjerë dhe kishte të bënte me çdo përmbajtje që duket se inkurajon apo paraqet vetëlëndimin ose vetëvrasjen në mënyrë joshëse.

Hapësirat online mund të jenë edhe të dobishme

"Të kesh një person tjetër që të thotë "e kuptoj" është shumë validuese."

Pavarësisht këtyre shqetësimeve, pothuajse tre të katërtat (73%) e të anketuarve ranë dakord se hapësirat onlinemund të jenë të dobishme për individët që përjetojnë vetëlëndim dhe ndjenja për vetëvrasje. Të anketuarit theksuan se hapësirat në internet ofrojnë "mbështetje të individëve me përvoja të ngjashme që shpëton jetën" dhe i lejojnë njerëzit të ndihen më pak të vetmuar dhe të ndajnë këshilla për përbalimin e shqetësimeve. Ata gjithashtu raportuan se mbështetja e kolegëve në internet shpesh plotëson boshllëqet në shërbimet e kujdesit shëndetësor mendor, pasi mund të arrihet tekta pritet të marrë mbështetje më formale. Disa të anketuar komentuan se përmbajtja në internet (p.sh., artikujt e lajmeve) mund të jetë e dobishme për rritjen e ndërgjegjësimit në mënyrë pozitive për vetëlëndimin dhe vetëvrasjen, dhe rrëfimet e përvojës së jetuar të rikuperimit mund t'u ofrojnë shpresë të tjerëve.

Ne duhet të njohim rreziqet e rritjes së legjislacionit në këtë fushë

"Gjëja e fundit që njerëzit më të ndjeshëm kanë nevojë është të shohin fjalët tona të zhduken nga interneti sepse shqetësimi ynë është kriminalizuar."

Shumë të anketuar menduan se është e rëndësishme të sigurohet që këto përfitime të hapësirave online të mos rrezikohen nga ligjet e reja. Disa të anketuar ishin të shqetësuar për ndikimin e legjislacionit tek përdoruesit e cenueshëm të cilët mund të përjetojnë shqetësime ekstreme mendore. Shumë të anketuar menduan gjithashtu se është e rëndësishme të sigurohet që trajtimi i përmbajtjes së dëmshme të mos rrisë pa dashje turpin dhe stigmën midis individëve që përjetojnë vetëlëndim ose mendime për vetëvrasje.

Ne duhet të adoptojmë strategji për t'i bërë hapësirat në internet më të sigurta

Për ta bërë internetin më të sigurt, 74% e të anketuarve menduan se të gjitha hapësirat në internet duhet të shfaqin numrat e linjave të ndihmës ose informacione të sinjalizimit në lidhje me vetëvrasjen ose mbështetjen e shëndetit mendor. Përveç kësaj, 67% besonin se të gjitha hapësirat online duhet të kenë moderatorë të trajnuar për

ndërgjegjësimin e shëndetit mendor. Shumë të anketuar ranë dakord që të gjitha hapësirat në internet duhet të heqin përmbajtjen që përmban përshkrime të hollësishme të lëndimit (63%) dhe se ata duhet t'u ofrojnë përdoruesve burime të kujdesit për veten (57%). Megjithatë, vetëm gjysma e të anketuarve mendonin se hapësirat online duhet të censurojnë përmbajtjet potencialisht të dëmshme që lidhen me vetëlëndim dhe vetëvrasje (51%). Këto gjetje janë në përputhje me ato nga një sondazh i ndërmarrë nga Aleanca Kombëtare e Parandalimit të Vetëvrasjeve në shtator 2021.

Konkluzioni

Kështu, kjo na kthen te pyetja: A është projektligji i ardhshëm një mundësi apo sfidë për vetëlëndimin dhe parandalimin e vetëvrasjeve? Pikëpamjet e njerëzve me përvojë të jetuar dhe baza e provave në zhvillim janë të qarta. Ka gjasa të jetë të dyja. Është padyshim një mundësi e rëndësishme për të zvogëluar qasjen ndaj përmbajtjeve të dëmshme të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes, por ka dy sfida të mëdha.

Fushëveprimi: Me qëllimin siç është hartuar, ka gjasa që platformat dhe shërbimet më të vogla nuk do të kenë nevojë të bëjnë ndogjë në lidhje me përmbajtjen ligjore por të dëmshme në lidhje me të rriturit. Shërbime të tilla si Wikipedia që kanë shtrirje të lartë, besim të lartë, por funksionalitet shumë të ulët mund të mos bien nën "Kategoriën 1", që do të thotë se për sa kohë që fëmijët nuk mund të kenë qasje në përmbajtje të dëmshme në të, atëherë ata nuk kanë nevojë të ndërmarrin asnjë veprim. Kjo është qartazi shqetësuese kur mendoni për informacione të detajuara në metodë mësimore që mund të shkaktojnë dëm.

Përkufizimet e dëmit: Është një sfidë e rëndësishme përpara Ofcom mbi përcaktimin e përmbajtjes së dëmshme që lidhet me vetëvrasje dhe vetëlëndim, me prova të kufizuara dhe mundësinë që kjo të ndryshojë varësisht nga njeriu dhe në varësisht nga niveli i shqetësimit të personit që angazhohet me përmbajtjen. Marrja e përmbajtjes e cila është e dëmshme pa ndonjë mëdyshje si pikënisje do të ishte një qasje e dobishme.

Por, edhe duke i lënë anash këto sfida dhe duke u fokusuar vetëm te mundësia, legjislacioni në vetvete nuk do të jetë i mjaftueshëm. Megjithëse zbatimi i një kuadri të fortë legjislativ do të ndihmojë në rregullimin e përmbajtjeve të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes online, është e rëndësishme të mbajmë në mend se kjo është vetëm një pjesë e problemit. Nëse duam të sigurojmë që interneti të bëhet një hapësirë më e sigurt për përdoruesit e cenueshëm, është thelbësore që të kemi një qasje të shumëanshme. Kjo kërkon të sigurohet që njerëzit e të

gjitha moshave të jenë të informuar dhe t'u jepen mjetet që u nevojiten për ta mbajtur veten të sigurt online kur përfshihen me përmbajtje për vetëlëndim dhe vetëvrasje. Kjo po ashtu do të thotë se profesionistët, si praktikuesit e shëndetit mendor, mësuesit dhe punonjësit socialë, duhet të kenë vetëbesimin dhe aftësitë e nevojshme për të mbështetur njerëzit rreth aktiviteteve të tyre online dhe për t'i udhëzuar ata në hapësirat mbështetëse online.

Duke pasqyruar këtë nevojë për një qasje të shumëanshme, në vitin 2019 Samaritans nisën Programi i Ekselencës Online tonë në bashkëpunim me Departamentin e Shëndetësisë dhe Kujdesit Social në Mbretërinë e Bashkuar dhe partnerët e sektorit dixhital për të krijuar një qendër përsosmërie në parandalimin e vetëvrasjeve online. Qëllimi i programit është të zvogëlojë qasjen në përmbajtje të dëmshme në internet dhe të rrisë mundësitë për mbështetje për përdoruesit e cenueshëm. Ne kemi prodhuar udhëzime të industrisë për faqet dhe platformat për menaxhimin e sigurt të përmbajtjes së vetëlëndimit dhe vetëvrasjes, të cilat besojmë se ofrojnë një pikënisje të fortë për Ofcom, si dhe kemi një shërbim këshillues për platformat dhe punën e profesionistëve në hapësirë. Ne gjithashtu kemi burime për përdoruesit dhe ata përreth tyre për t'i ndihmuar ata të krijojnë dhe të ndajnë përmbajtje në mënyrë të sigurt.

Përmirësimi i sigurisë në internet do të kërkojë gjithashtu teknologji më të sofistikuar të inteligjencës artificiale për të zbuluar dhe menaxhuar në mënyrë të shpejtë dhe efektive përmbajtjen e vetëlëndimit dhe vetëvrasjes online, dhe që kjo teknologji të jetë e disponueshme për platformat e të gjitha madhësive dhe kapaciteteve. Ata/o që janë përgjegjës për përmbajtje në platforma të rrjeteve sociale dhe forume online duhet të edukohen për të zbatuar kodet e praktikës në një mënyrë të sigurt, në mënyrë që ata të heqin përmbajtjen në mënyrë të sigurt dhe t'i drejtojnë përdoruesit me ndjeshmëri në mbështetjen e duhur.

Së fundi, ekziston një nevojë urgjente për të financuar dhe porositur hulumtime që adresojnë boshllëqet në njohuritë se cilat lloje të përmbajtjeve online kanë më shumë gjasa të shkaktojnë dëm, kur dhe kujt. Vetëm duke adoptuar një qasje të shumëanshme ndaj dëmeve online, mund të ndërtojmë komunitete më të sigurta online që shfrytëzojnë fuqinë e internetit për të ofruar parandalimin efektiv të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes.

Referenca

Arendt, F., Scherr, S., & Romer, D. (2019). Effects of exposure to selfharm on social media: Evidence from a two-wave panel study among young

- adults. *New Media & Society*, 21(11–12), 2422–2442.
<https://doi.org/10.1177/1461444819850106>
- Biddle, L., Derges, J., Goldsmith, C., Donovan, J. L., & Gunnell, D. (2018). Using the internet for suicide-related purposes: Contrasting findings from young people in the community and self-harm patients admitted to hospital. *PLoS ONE*, 13(5), e0197712.
<https://doi.org/10.1371/journal.pone.0197712>
- Biddle, L., Gunnell, D., Owen-Smith, A., Potokar, J., Longson, D., Hawton, K., Kapur, N., & Donovan, J. (2012). Information sources used by the suicidal to inform choice of method. *Journal of Affective Disorders*, 136(3), 702–709.
- Biddle, L., Gunnell, D., Sharp, D., & Donovan, J. L. (2004). Factors influencing help seeking in mentally distressed young adults: A cross-sectional survey. *The British Journal of General Practice*, 54(501), 248–253.
- Conservative and Unionist Party. (2019). The Conservative and Unionist Party manifesto. <https://www.cpa.org.uk/cpa/docs/Election2019/ConservativeManifesto2019.pdf>
- Criminal Justice Act (Northern Ireland), c. 20 (1966). <https://www.legislation.gov.uk/apni/1966/20/contents>
- Davis, S., & Lewis, C. A. (2019). Impassioned communication and virtual support roles of online postings: The case of self-harmers. *Illness, Crisis & Loss*, 27(1), 19–35.
<https://doi.org/10.1177%2F1054137318780585>
- Department for Digital, Culture, Media and Sport (DCMS). (2020). Online harms white paper: Full government response to the consultation. <https://www.gov.uk/government/consultations/onlineharms-white-paper/outcome/online-harms-white-paper-fullgovernment-response>
- Department for Digital, Culture, Media and Sport (DCMS). (2021). Draft Online Safety Bill presented to parliament by the Minister of State for Digital and Culture by Command of Her Majesty, May 2021. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/985033/Draft_Online_Safety_Bill_Bookmarked.pdf
- HM Government. (2019). Online harms white paper. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/973939/Online_Harms_White_Paper_V2.pdf
- Joint Committee on the Draft Online Safety Bill. (2021). Draft Online Safety Bill: Report of session 2021–22. (2021–22, HL 129, HC 609). <https://committees.parliament.uk/publications/8206/documents/84092/default/>
- Lavis, A., & Winter, R. (2020). #Online harms or benefits? An ethnographic analysis of the positives and negatives of peer-support around self-harm on social media. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 61(8), 842–854.
<https://doi.org/10.1111/jcpp.13245>
- Law Commission. (2021). Modernising communications offences (Law Com. No. 399). <https://s3-eu-west-2.amazonaws.com/lawcom-prod-storage-11jsxou24uy7q/uploads/2021/07/Modernising-Communications-Offences-2021-Law-Com-No-399.pdf>
- Marchant, A., Hawton, K., Stewart, A., Montgomery, P., Singaravelu, V., Lloyd, K., Purdy, N., Daine, K., & John, A. (2017). A systematic review of the relationship between internet use, self-harm and suicidal behaviour in young people: The good, the bad and the unknown. *PLoS ONE*, 12(8), e0181722.
- Mars, B., Heron, J., Biddle, L., Donovan, J. L., Holley, R., Piper, M., Potokar, J., Wyllie, C., & Gunnell, D. (2015). Exposure to, and searching for, information about suicide and self-harm on the internet: Prevalence and predictors in a population based cohort of young adults. *Journal of Affective Disorders*, 185, 239–245.
<https://doi.org/10.1016/j.jad.2015.06.001>
- Mok, K., Jorm, A. F., & Pirkis, J. (2016). The perceived impact of suicide-related internet use: A survey of young Australians who have gone online for suicide-related reasons. *DIGITAL HEALTH*, 2. <https://doi.org/10.1177/2055207616629862>
- Padmanathan, P., Biddle, L., Carroll, R., Derges, J., Potokar, J., & Gunnell, D. (2018). Suicide and self-harm related internet use. *Crisis*, 39(6), 469–478.
<https://doi.org/10.1027/0227-5910/a000522>
- Suicide Act, c. 60 (1961). <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/Eliz2/9-10/60>
- The National Confidential Inquiry into Suicide and Safety in Mental Health Illness (NCISH). (2017). Suicide by children and young people. University of Manchester, UK. <https://documents.manchester.ac.uk/display.aspx?DocID=37566>

Publikuar online 2 Mars, 2022

Jacqui Morrissey

Samaritans

Upper Mill

Kingston Road

Ewell, KT17 2AF

UK

j.morrissey@samaritans.org

Jacqui Morrissey, MSc, është asistente drejtore për hulumtime dhe influenza në Samaritans, shoqata bamirëse udhëheqëse në parandalim të vetëvrasjes e cila punon anëmbanë Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, dhe bashkëkryetare e Aleancës Nacionale të Parandalimit të Vetëvrasjes në Angli. Ajo është e përkushtuar në sigurimin e përkthimit të hulumtimeve në praktike, në mënyrë që të ndihmojë në parandalimin e vetëvrasjes.

Laura Kennedy, MPhil, është hulumtuese dhe oficer e gjetjeve për ekipin e dëmeve online në Samaritans. Ajo është gjithashtu kandidate e PhD në fushën e kriminologjisë në Universitetin e Cambridge. Hulumtimi i saj primar fokusohet në parandalimin e vetëvrasjes, ndikimin e personave me përvoja të ngjashme dhe adoleshencës.

Lydia Grace, PhD, është menaxhere e programeve për hulumtime dhe politika në Samaritans. Ajo udhëheqë Programin Online të Përsosmërisë, duke punuar me qeverinë dhe industrinë për të zhvilluar një qendër të përsosmërisë në parandalimin e vetëvrasjes online. PhD e saj eksploron memoriet dhe vetë-konceptimet në depresion dhe interesat hulumtuese të saj përfshijnë parandalimin e vetëvrasjes dhe intervenime online.